



**PROJEKT - PREVENTIVAT PER RIKONSTRUKSIONIN E DISA QENDRAVE  
SHENDETESORE DHE AMBULANCAVE PER VITIN 2023 - 2024**

**LOT II - NJESIA VENDORE DEVOLL  
AMBULANCA PILUR**



**POROSITES:**  
MINISTRIA E SHENDETESISE DHE DREJTORITE RAJONALE  
TE SHENDETESISE DHE DREJTORITE E SHENDETIT PUBLIK.



**HARTOI PROJEKTIN:**  
Taulant sh.p.k



Rr. Gjik Kuqali  
Pll.23/2 Shk.1,Ap.1 Kati 1, Tirana  
+355 4 2456016  
shpk.taulant2@gmail.com



MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE  
MBROJTJES SOCIALE DHE NJËSITË  
VENDORE TË SHËNDETËSISË

## SPECIFIKIME TEKNIKE

**Objekti: "Projekt preventiva për rikonstruksionin e disa qendrave  
shëndetësore & ambulancave, për vitin 2023-2024 (Loti 2)"  
Qendra shendetesore Pilur (Devoll),Qarku KORCE**

**POROSITËS: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale  
si dhe njësitë vendore të shëndetësisë**



**KONSULENT: "TAULANT" SH.P.K.**



***PERMBAJTJA***  
**QENDRA SHENDETESORE PILUR (DEVOLL)**

- 1.HYRJE
- 2.OBJEKTIVI I DETYRES SE PROJEKTIMIT
- 3.REZULTATET E PRITSHME NGA OFRUESI I SHËRBIMIT
4. QENDRA SHENDETESORE PILUR(DEVOLL)–Qarku KORCE
- 5.TE PERGJITHSHME
- 6.PUNIME NDERTIMI DHE RIKONSTRUKSIONI
- 7.SISTEMI I MBROJTJES KUNDER ZJARRIT
8. PAISJET DHE MATERIALET E DUHURA PER INSTALIMET HIDROSANITARE
- 9.RAMPA
- 10.SISTEMI I NGROHJES DHE KONDICIONIMIT

## 1. Hyrje

Shërbimi parësor në vendin tonë është bazuar në funksionimin e qendrave shëndetësore dhe ambulancave (njësive shëndetësore) të ngritura në nivel të njësive administrative perberese të bashkive (njësi bashkiake, ish-komuna). Ky shërbim është publik dhe infrastruktura e tij është ngritur në bazë të respektimit të standardeve kombëtare të aprovuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Janë 421 qendra shëndetësore që funksionojnë si njësi autonome në qytet dhe në fshat, të cilat janë kontraktuar për shërbimet shëndetësore që ofrojnë nëpërmjet skemës së detyrueshme të sigurimit shëndetësor.

Në pjesën më të madhe të vendit, QSh është një organizim, që përfshin disa ambulanca. Ambulancat në qytete dhe në fshatra (ose njësi shëndetësore) janë mesatarisht 3-4 për çdo qender shëndetësore dhe janë të varura nga ana administrative nga qendrat shëndetësore. Personeli i QSh (ku përfshihen dhe ambulancat) përbëhet nga mjekë, infermiere, mami dhe personel mbështetës. Pra, shërbimet e kujdesit shëndetësor nuk ofrohen në një godinë të vetme, por nëpërmjet një rrjeti ofruesish të shërbimeve shëndetësore, të cilët punojnë afër komuniteteve. Çdo njësi administrative ka detyrimisht një QSh dhe çdo fshat ka një ambulancë ku shërben të paktën një infermiere.

Mesatarisht, çdo QSh i shërben një popullatë prej 8,000 –10,000 vetësh (kjo shifër luhet ndjeshëm në zonat urbane dhe rurale), duke patur një raport mjek/pacient rreth 1 me 2500 dhe raport infermiere/pacient rreth 1 me 400 banorë. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2023 ka ndërmarrë iniciativën për realizimin e projekt-preventivave të zbatimit për disa objekte të shërbimit parësor (qendra shëndetësore dhe ambulanca) në disa rajone, objekte për të cilat u realizuan projektet gjatë vitit 2015, vit kur Ministria realizoi investimin për projekt preventivat e qendrave shëndetësore dhe ambulancave në 10 qarqe.

Gjatë vitit 2018 MSHMS realizoi procedurën e prokurimit për rikonstruksionin e 67 objekteve qsh/amb në të gjithë vendin, por gjatë zbatimit të punimeve hasi në disa vështirësi, si degradim të situatës së infrastruktures së objekteve, disa lloj punimesh ishin harruar të parashikoheshin në preventiv, etj. Për këto arsye dhe për arsye të tjera si permbytje, termetet e viteve të fundit, degradim i situatës etj, u arrit në perfundimin që projekt preventivat e realizuara në vitin 2015, që janë perzgjedhur për rikonstruksion gjatë vitit 2023 të rishikohen për t'u përmirësuar.

Gjatë vitit 2018 MSHMS realizoi procedurën e prokurimit për rikonstruksionin e 67 objekteve qsh/amb në të gjithë vendin, por gjatë zbatimit të punimeve hasi në disa vështirësi, si degradim të situatës së infrastruktures së objekteve, disa lloj punimesh ishin harruar të parashikoheshin në preventiv, etj.

Për këto arsye dhe për arsye të tjera si permbytje, termetet e viteve të fundit, degradim i situatës etj, u arrit në perfundimin që projekt preventivat e realizuara në vitin 2015, që janë perzgjedhur për rikonstruksion gjatë vitit 2023 të rishikohen për t'u përmirësuar.

## 2.OBJEKTIVI I DETYRES SE PROJEKTIMIT.

Objektivi i kësaj Detyre Projektimi është vlerësimi ekonomik-teknik i çdo godine që ka nevojë për nderhyrje. Qëllimi është:

Te paraqese të dhena dhe të propozojë zgjidhjen më të mirë të mundshme bazuar në mundësitë e shfrytëzimit nga ana e institucionit.

Te parashtrijë kërkesat për një funksionim normal dhe dinjitoz si një godinë shëndetësore

Të parashtrijë kërkesat për një godinë institucioni me vlera bashkëkohore dhe funksionale.

### 3. REZULTATET E PRITSHME NGA OFRUESI I SHËRBIMIT.

Ofruesi i shërbimit të rishikimit të projekteve, do të paraqesë si produkt të tijë në përfundimin e kontrates, projektin e plote, specifikimet teknike, grafikun e punimeve për çdo objekt - qender shëndetësore/ambulance që ka nevojë për rikonstrukcion.

Në listën bashkangjitur janë paraqitur të gjitha qendrat shëndetësore dhe ambulancave, e perzgjedhura shoqëruar me sipërfaqet e tyre, si dhe vendndodhja e tyre. Nga ana e njesive vendore të kujdesit shëndetësor, është bërë një evidentim sipërfaqësor i gjendjes fizike të tyre, shoqëruar me foto, nisur nga mungesa e stafit teknik në këto drejtori. Për këtë arsye në kemi përgatitur një detyrë projektimi të përgjithshme. Ofruesi I shërbimit me të cilin do të lidhet kontrata, do të duhet të verifikojë vetë gjendjen e secilës godinë (sipas qarqeve) dhe nëse është e domosdoshme/e nevojshme, do të bazohet të kjo detyrë projektimi si dhe të projektet e para për të realizuar projekt preventivin e zbatimit.

### 4.QENDRA SHENDETESORE PILUR – Qarku KORCE

Ky specifikim teknik është dokument kontraktor, është hartuar nga studio projektuese enkas për "Rikonstrukcionin e e godinave të qendrave shëndetësore dhe ambulancave të **Qarkut Te KORCES**".

Zerat e rradhitur në këtë specifikim, përkohje me zerat e preventivuar, mbështetur në projektin e hartuar dhe në "Manualin teknik të çmimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre" të miratuar nga K.M i Republikës së Shqipërisë me vendimet të korrikut 2015.

Standartet e cilësive të materialeve të përdorura janë, ato të shtetit Shqiptar për materialet prodhim vendi dhe ato të vendeve të Bashkimit Europian për materialet e importit. Në këto raste Administratori i kontrates vec certifikates së origjines mund të kërkojë dhe certifikat e cilësive dhe të dhënat për performancën teknike të artikujve që do të furnizohen. Standartet e përdorura në këtë specifikim teknik, nuk janë mbështetur vetëm në vizatimet e projektit, kushtet teknike të projektimit dhe të zbatimit, por edhe në manualin ligjor dhe në libra të tjera. Këto specifikime teknike, nuk mund të përdoren për objekte të tjera. Subjekti i përfshirë në realizimin e objektit të kësaj kontrate, në rast problemi, mund të bëjë sugjerime, përmirësime dhe plotësime të këtyre specifikimeve, nëse kërkohet nga ndryshime të mundshme të kategorive të punimeve ose mungesa e detajeve dhe e materialeve.

### 5.Te përgjithshme

Paragrafet në këtë kapitull janë plotësuese të detajeve të dhëna në Kushtet e Kontrates dhe i shërbejnë kontraktorit për fazën e përgatitjes së ofertes dhe supervizorit gjatë fazës së zbatimit. Kontraktori dhe supervizioni duhet të kenë parasysh që :

1. Zëvendësimi i materialeve të specifikuar në Dokumentin e Kontrates do të bëhet vetëm me aprovimin e Supervizorit nëse materiali i propozuar për tu zëvendësuar është i njëjti ose më i mirë se materialet e specifikuar; ose nëse materialet e specifikuar nuk mund të sillen në sheshin e ndërtimit në kohë për të përfunduar punimet e Kontrates, për shkak të kushteve jashtë kontrollit të Kontraktorit. Që kjo të merret në konsideratë, kërkesa për zëvendësim do të shoqërohet me një dokument- dëshmi të cilësive, në formën e kuotimit të certifikuar dhe të datës së garancisë të dorëzimit nga furnizuesit e të dy materialeve, si të materialit të specifikuar ashtu edhe të atij që propozohet të ndryshohet.

2. Kontraktori do të verifikojë të gjitha dimensionet, sasitë dhe detajet të treguar në Vizatimet, Grafiket, ose të dhëna të tjera dhe Pundhënesi nuk do të mbajë përgjegjësi për ndonjë mangësi ose mospërputhje të gjetur në to. Moszbulimi ose korrigjimi i gabimeve ose mospërputhjeve nuk do ta lehtësojë

Kontraktorin nga pergjegjesia per pune te pakenaqeshme .Kontraktori do te marre persiper te gjithë pergjegjesine ne berjen e llogaritjeve te madhesive , llojeve dhe sasive te materjaleve dhe pajisjeve te perfshira ne punen qe duhet bere sipas Kontrates. Ai nuk do te lejohet te kete avantazhe nga ndonje gabim ose mosperputhje, ndersa nje udhezim i plote do te jepet nga Punedhenesi ne se gabime te tilla ose mosperputhje do te zbulohen.

3. Kontraktorit nuk do te behet asnje pagese mbi cmimet njesi te kuotuar per kostot e mobilizimit d.m.th. per sigurimin e transportit, drite, energjine ,veglat dhe pajisjet,ose per furnizimin e godines dhe mirembajtjen e impjanteve te ndertimit,rrugeve te hyrjes,te komoditeteve sanitare heqje e mbeturinave, punen, furnizimin me uje, mbrojtjen kundra zjarrit, bangot e punes, rojet, rrjetin telefonik si dhe struktura te tjera te perkoheshme, pajisje dhe materjale, ose per kujdesin mjeksor dhe mbrojtjen e shendetit, ose per patrullat dhe rojet, ose per ndonje sherbim tjetër, lehtesi, gjera, ose materjale te nevojshme ose qe kerkohen per zbatimin e punimeve ne perputhje me ate qe eshte parashikuar ne Kontrate.

4.Kontraktori te organizoje punen per ndertimin, mirembajen dhe me pas te spostoje dhe ta rivendose cdo rruge hyrje qe do te duhet ne lidhje me zbatimin e punimeve . Cvendosja do te perfshije pershtatjen e zones me cdo rruge hyrje dhe se paku me shkalle sigurie,qendrushmerie dhe te kullimit te ujrave siperfaqesore te njejte me ate qe ekzistonte perpara se Kontraktori te hynte ne Shesh.

5. Kontraktori ujin qe nevojitet per zbatimin e punimeve do te merret nga rrjeti kryesor nepermjet nje matesi ne piken me te afert te mundeshme.Kontraktori do te shtrije rrjetin e vet te perkoheshem te tubacioneve . Lidhjet me rrjetin kryesor dhe kostot per kete do te pagohen nga Kontraktori. Ne rastet kur nuk ka mundesi lidhje me rjetin kryesor, Kontraktori duhet te beje vete perpjekjet per furnizimin me uje higjenikisht te paster dhe te pijshem per punetoret dhe punimet.

6. Kontraktori do te beje perpjekjet dhe me shpenzimet e tij per furnizimin me energji elektrike ne kantier, si me kontraktim me KESH – in , kur lidhjet me rrjetin kryesor lokal jane te mundura , ose duke parashikuar gjeneratorin e vet per te permbushur kerkesat.

7. Kontraktori , me shpenzimet e tij duhet te beje ndertimin e modinave dhe te piketave sic kerkohet, ne perputhje me informacionin baze te Punedhenesit,dhe do te jete pergjegjesi i vetem per perpikmerine. Kontraktori do te jete pergjegjes per te kontrolluar dhe verifikuar informacionin baze qe i eshte dhene dhe ne asnje menyre nuk do te lehtesohet nga pergjegjesia e tij ne se nje informacion i tille eshte i manget, jo autentik ose jo korrekt .Ai nderkohe do te jete subjekti qe do te kontrollohet dhe rishikohet nga Punedhenesi ,dhe ne asnje rast nuk i jepet e drejta te beje ndryshime ne vizatimet e kontrates , per asnje lloj kompensimi per korrigjimet e gabimeve ose te mangesive .Kontraktori do te furnizojë dhe mirembaje me shpenzimet e tij, rrethimin dhe materiale te tjera te tilla dhe te jape asistenca nepermjet nje stafi te kualifikuar sic mund te kerkohet nga Punedhenesi per kontrollin e modinave dhe piketave.

8. Kontraktori do të ruaje të gjitha pikat e akseve, modinat, shenjat e kuotave, të bera ose të vendosura gjatë punës, të mbulojë koston e rivendosjes së tyre nëse ato demtohen dhe të mbulojë të gjitha shpenzimet për ndreqjen e punës së bërë jo mirë për shkak të mosmirembajtjes ose mbrojtjes ose spostimit pa autorizim të këtyre pikave të vendosura, modinave dhe piketave.

Përpara çdo aktiviteti ndertimor, Kontraktori do të ketë linjat e furnizimit me ujë dhe energji elektrike të vendosura në terren, të drejten e kalimit të qarte dhe të sheshuar, gati për fillimin e punimeve. Çdo punë e bërë jashtë akseve, kuotave dhe kufijve të treguara në vizatime ose të mosmiratuara nga Punedhësi nuk do të paguhet, dhe Kontraktori do të mbulojë me shpenzimet e tij germimet shtesë gjithmone nën drejtimin e Supervizorit.

9. Kontraktori duhet të bëjë fotoграфи me ngjyra sipas udhëzimeve të Supervizorit në vendet e punës për të demonstruar kushtet e sheshit përpara fillimit, progresin gjatë punës së ndertimit dhe mbas përfundimit të punimeve. Nuk do të behen pagesa për fotografimin e kantierit të punimeve pasi këto shpenzime janë parashikuar të mbulohen nën koston administrative të Kontraktorit.

10. Kontraktori duhet të ketë vecanerisht kujdes në:

a) nevojën për të mirembajtur shërbimet ekzistuese dhe mundësitë e kalimit për banorët dhe tregëtarët që janë në zonë gjatë periudhës së ndertimit.

b) prezencën e mundshme të kontraktoreve të tjerë në zonë me të cilët do të koordinohet puna.

E gjithë puna do të behet në një mënyrë të tillë që të lejojë hyrjen dhe përballimin e të gjithë pajisjeve të mundshme për ndonjë Kontraktor tjetër dhe punëtorëve të tij, stafin e Punedhësit si edhe të çdo punonjësi që mund të punësohet në zbatim dhe/ose punimet në zonë ose pranë saj për çdo objekt që ka lidhje me Kontraten ose çdo gjë tjetër.

Në përgatitjen e programit të tij të punës Kontraktori gjatë gjithë kohës do të bëjë llogari të plote dhe do të koeporojë me programin e punës së Kontraktoreve të tjerë në mënyrë që të shkaktojë një minimum interference me ta dhe me publikun. Nga Punedhësi rekomandohet që punëtorët e pakualifikuar të merren nga zona.

11. Kontraktori do të marrë masa paraprake për mbrojtjen e punëtorëve të punësuar dhe të jetes publike si edhe të pasurive në dhe rreth sheshit të ndertimit. Masat e sigurimit paraprak të ligjeve të aplikushme, kodeve të ndertesave dhe të ndertimit do të respektohen. Makinerite, pajisjet dhe çdo rrezik do të këqyren ose eliminohen në përputhje me masat paraprake të sigurimit.

12. Kontraktori, gjatë zbatimit të punimeve me shpenzimet e veta, duhet të vendosi dhe të mirembajë gjatë natës pengesa të tilla dhe drita të cilat do të parandalojnë në mënyrë efektive aksidentet. Kontraktori duhet të sigurojë pengesa të pershtateshme, shenja me drite të kuqe "rrezik" ose "kujdes" dhe vrojtues në të gjitha vendet ku punimet mund të shkaktojnë crregullime të trafikut normal ose që perbejnë në ndonjë mënyrë rrezik për publikun.



13. Kontraktori, me shpenzimet e veta, duhet të ndermarre të gjithë veprimet e mundshme për të siguruar që ambienti lokal i sheshit të ruhet dhe që vijat e ujit, toka dhe ajri (duke përfshirë edhe zhurmat) të jenë të pastra nga ndotja për shkak të punimeve të kryera . Mos plotesimi i kesaj klauzole në baze të evidentimit nga Supervizori, mund të çojë në ndërprerjen e kontrates.

14. Kontraktori transportin e çdo materiali nga kavot, nyjet apo magazinat e ndryshme, do të bëjë me makina të pershtateshme të cilat kur ngarkohen nuk shkaktojnë derdhje dhe të gjithë ngarkesa të jete të siguruar. .Ndonjë makine që nuk ploteson këto kërkesë ose ndonjë nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do të hiqet nga kantieri. Të gjitha materialet ,duhet të stivohen ose të magazinohen në mënyrë të pershtateshme për të mbrojtur nga rreshqitjet, demtimet, thyerjet, vjedhjet dhe në dispozicion për tu kontrolluar nga Supervizori në çdo kohë.

15. Kontraktori duhet të bëjë me shpenzimet e tij, të marre me qira ose të blerje një terren të mjaftueshëm për ngritjen e magazinave dhe zyrave të tij dhe për krijimin e një zyre për Supervizorin siç është specifikuar, të gjitha këto me shpenzimet e tij.

16. Kontraktori duhet të përgatise vizatimet për të gjitha punimet "sic janë faktikisht zbatuar" në terren. Vizatimet do të behen në një standart të ngjashëm me atë të vizatimeve të Kontrates.

Gjate zbatimit të punimeve në kantier, Kontraktori do të ruajë të gjithë informacionin e nevojshëm për përgatitjen e "Vizatimit sic është zbatuar". Do të shenojë në mënyrë të qartë vizatimet dhe të gjitha dokumentet e tjera, të cilat mbulojnë punën e vazhdueshme të perfunduar, material i cili do të jete i disponueshëm në çdo kohë gjate zbatimit për Supervizorin. Keto vizatime do të azhurnohen në mënyrë të vazhdueshme dhe do të dorëzohen Supervizorit çdo muaj për aprovim, pasi Punimet të këne perfunduar, sebashku me kopjen perfundimtare. Materiali mujor do të dorëzohet në kopje leter.

Vizatimet e riprodhuara do të përfshijnë pozicionin dhe shtrirjen e të gjithë konstruksioneve mbajtëse të lena gjate germimeve dhe vendosjen ekzakte të të gjitha shërbimeve që janë ndeshur gjate ndertimit. Kontraktori, gjithashtu duhet të përgatise seksionet e profilit gjatesor të rishikuar, pajisur me shenimet që tregojnë shtresat e tokës që hasen gjate të gjitha punimeve të germimit.

Si perfundim, kopjet e riprodhuara të Vizatimeve " sic është zbatuar" do t'i dorëzohen Supervizorit për aprovim. Vizatimet "sic është zbatuar" ,të aprovuara, do të behen prone e Punedhënesit.

17. Kontraktori në perfundim të punës, sa here që është e aplikueshme, me shpenzimet e tij, duhet të pastroje dhe të heqë nga sheshi të gjitha impiantet ndertimore, materialet që kanë tepruar, mbeturinat, skelerite dhe ndertimet e perkoheshme të çdo lloji dhe të lere sheshin e tere dhe veprat të pastra dhe në kondita të pranueshme. Pagesa perfundimtare e Kontrates do të mbahet deri sa kjo të realizohet dhe pasi të jepet miratimi nga Supervizori.

## **6. PUNIME NDERTIMI DHE RIKONSTRUKSIONI**

### **6.1.Prishja e catise perfshin:**

Heqjen e mbuleses, e cila mund te jete me tjegulla ose llamarina te llojeve te ndryshme, me panele sanduic e ndonje material tjetër dhe uljen e tyre pooshte; perfshire dhe heqjen e ullukeve horizontale dhe vertikale sipas rastit.

Cmontimin e konstruksionit mbajtes se catise, I cili mund te jete I tipit vendi me lende te rumbullaket me kapriate derase apo dhe me konstruksiuon metalike, dhe uljen e materialeve poshte. Sipas rastit grumbullimin, stivimin apo dhe transportin per ne magazinat e investitorit si te jete parashikuar ne preventive apo si ta percaktoje supervizori.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.

### **6.2.Prishja tavane e korniza catie perfshin:**

Heqjen e tavanit dhe te kornizave te catise, pavaresisht nga materiali me te cilen ai eshte realizuar derrase, res kallan. + suva, rrjet teli + suva apo dhe plasteke; perfshire dhe strukturen mbajtese.

Skelen, spostimin e materialeve qe rezultojne nga heqja brenda ambientit te kantierit si dhe cdo detyrim tjetër per ti dhene plotesisht fund heqjes se tavanit.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.

### **6.3.Prishje e shtresa, veshje shkalle , davancale dhe llustra perfshin :**

Prishjen e shtresave te dyshemeve, veshjeve te shkalleve, davancaleve te dritareve dhe llustrave dhe trotuareve kur ajo kerkohet; pavaresisht nga mbishtresa pllaka granili, betoni gres, mermer, parket etj.

Prishjen e shtresës se Llaçit, te kolles apo nenstrukturat e shtreses se parketit dhe spostimin e materialeve qe rezultojne nga prishjet; pa demtuar bazamentin e tyre e vecanerisht murin ne rastin e davancaleve dhe shtresat e katramase ne rastim e teracave.

Dorezimin e atyre pjeseve te materialeve qe ne preventiv eshte parashikuar te rikuperohet duke i depozituar apo transportuar ne vendin ku cakton investitori nepermjet supervizorit. Materialet qe kerkohet te rikuperohen do te dorezohen me proces verbal.

- Çdo detyrim tjetër per mbarimin e plote dhe shqepjes se shtreses se dyshemese dhe garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit ne menyre perfekte.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.

### **6.4.Prishje suvatimeve dhe veshjeve perfshin:**

Kontrollin me goditjen e te gjithe siperfaqes se suvatuar dhe percaktimin e pjesëve te mufatura dhe të plasaritura, per rastin kur prishja nuk eshte percaktuar te kryhet ne 100% te siperfaqeve.

Heqjen e plote ose e pjesshme e suvatimeve te soletave, te mureve dhe te fasadeve, deri ne bazamentin beton, gure, tulle bllok, pavaresisht nga trashesia e shtreses te kryer me çfarëdolloj mjete dhe e çfarëdo lartësie ose thellesie,

Skelen e sherbimit ose skelerine, armaturat e mundshme per te mbeshtetur ose mbrojtur strukturat ose ndertesat pereth, pa i demtuar ato.

Pastrimi i siperfaqeve te prishura nga mbeturinat dhe larja me uje te bollshem me presion. Goditjen e te gjitha siperfaqes se suvatuar dhe gjetjen e pjesëve te mufatura dhe të plasaritura nepermjet tingullit, prishjen e ketyre pjesëve deri në daljen e muraturës, ne mure dhe tavane, larje e siperfaqeve te prishura me uje me presion, duke perfshire skelat e sherbimit ose skelerine, spostimin e materialit qe rezulton brenda ambientit te kantierit si dhe çdo detyrim tjeter per ti dhene plotesisht fund heqjes së suvasë.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit

#### **6.5.Heqja dyer e dritare perfshin:**

Heqjen e dyerve dhe dritareve te çfarëdo lloji, dhe te cfardo permase, perfshire kasen, telajot, etj. Dorezimin e tyre sic parashikohet ne preventiv;

Depozitimin apo transportin ne vendin ku cakton investitori nepermjet supervizorit. Dyert dhe dritaret qe kerkohet te rikuperohen do te dorezohen me proces verbal.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

#### **6.6.Heqje zgara e kangjella hekuri perfshin:**

Heqje e zgarave te dritareve apo kangjellat e rrethimit prej hekurit te çfarëdo lloji, me prerje me saldim apo me shkuljen e tyre.

Depozitimin apo transportin ne vendin ku cakton investitori nepermjet supervizorit. Zgarat apo kangjellat qe kerkohet te rikuperohen do te dorezohen me proces verbal.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

#### **6.7.Heqje instalimeve elektrike perrfshin:**

Shkeputjen e burimit te ushqimit te sistemit ne menyre te sigurte , heqje pjeseve qe preventivi parashikon te rikuperohen sic jane ndricuesit dhe paisjet e ndryshme, dorezimin e tyre sic parashikohet ne preventiv; duke i depozituar apo transportuar ne vendin ku cakton investitori nepermjet supervizorit.

Heqjen e te gjitha kablove elektrike dhe tubave plastike, kutive, kuadrove, prizave, celesave elektrike, etj, ekzistuese, brenda ose jashte mureve te godines.

Transportimin ne nje vend public te mbetjeve nga prishjet. Riperdorimi i materialeve nuk lejohet ne asnje rast.

Pergjegjsine e kontraktorit, per cdo demtim shkaktuar punimeve te ndertimit per mos heqjen e kablove, tubave plastike, kutive, kuadrove, prizave, celesave elektrike te vjeter etj, dhe mos eliminimin e duhur te demeve.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

#### **6.8.Heqje instalimeve hidrosanitare perfshin:**

Shkeputje e linjes te ushqimit te sistemit ne menyre te sigurte, heqje aparateve qe preventivi parashikon te rikuperohen sic jane bojleret, kondicionert e e paisjet e ndryshme, dorezimin e tyre sic parashikohet ne preventiv; duke i depozituar apo transportuar ne vendin ku cakton investitori nepermjet supervizorit.

Heqja e aparateve hidrosanitare WC, Bide Lavaname, Pllaka dushi duke i nxjerr jashte objektit e duke i transportuar brenda dites per ne vendin e caktuar nga Bashkia. E njejta praktike pune do te ndiqet dhe me tubacionet e shkarkimit te ujrave te zeza. Dalohet reptesisht riperdorimi i tubove te shkarkimit te ujrave te zeza.

Heqjen e rrjetit te brendshme te furnizimit me uje, largimi i tyre ne depoziten e materialeve, nuk konsiderohen te kontaminuar.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.

#### **6.9.Gërmim dheu thellesi perfshin:**

Gërmim dheu themele ose per punime nentokesore, deri në thellesine 1,5 m nga rrafshi i tokes, ne truall te çfarëdo natyre dhe konsistence, te thare ose te lagur (argjile edhe n.q.s. eshte kompakte, rërë, zhavorr, gure etj..), perfshire prerjen dhe heqjen e rrenjeve, trungjeve, gureve dhe pjesëve me volum deri në 0,30 m<sup>3</sup>, plotesimin e detyrimeve ne lidhje me ndertimet e nendheshme si kanalet e ujrave te zeza, tubacionet ne pergjithesi etj.., Përforcimin e çfarëdo marke dhe rezistence, mbushjen e pjesëve që mbeten bosh pas realizimit te themeleve me materialin e Gërmimit te kryer me krah, si dhe spostimin brenda ambientit te kantierit.

Gërmim me seksion te caktuar, per themele me thellesi deri në 1.5 m nga rrafshi i tokes, ne terren te çfarëdolloj natyre dhe konsistence, te lagur ose te thate (argjile edhe n.q.s. eshte e ngjeshur, rërë, zhavorr, gure etj..) duke perfshire prerjen dhe heqjen e rrenjeve, trungjeve, gureve dhe pjesëve me volum deri në 0,30 m<sup>3</sup>, plotesimin e detyrimeve ne lidhje me ndertimet e nendheshme si kanalet e ujrave te zeza, tubacionet ne pergjithesi etj.., Përforcimin e çfarëdolloj marke dhe rezistence, mbushjen e pjesëve te mbetura bosh pas realizimit te themeleve, me materialin e Gërmimit te kryer me krah, duke perfshire zhvendosjen brenda ambientit te kantierit;

Gërmim poshte themeleve, per perforcime te nevojshme, deri në thellesine, gjerësine dhe largesine e dhene sipas udhezimeve ne projekt, ne terren te çfarëdo natyre dhe konsistence, te thare ose te lagur (argjile edhe n.q.s. eshte kompakte, rërë, zhavorr, gure etj..), perfshire prerjen dhe heqjen e rrenjeve, trungjeve, gureve dhe pjesëve me volum deri në 0,30 m<sup>3</sup>, plotesimin e detyrimeve ne lidhje me ndertimet e nendheshme si kanalet e ujrave te zeza, tubacionet ne pergjithesi etj.., Përforcimin e çfarëdo marke dhe rezistence, mbushjen e pjesëve që mbeten bosh pas realizimit te themeleve me materialin e gërmimit te kryer me dore, si dhe spostimin brenda ambientit te kantierit.

Perforcime te themeleve, ne thellesi, gjerësi dhe gjatësi sipas udhezimeve ne projekt, realizuar me beton M-100, sipas pikes 4.a.1, duke perfshire kallepet e mundshme, dhe çdo gje tjeter te nevojshme per ti dhene fund perforcimeve dhe per ti realizuar ne menyre perfekte.

#### **6.10.Transport dheu me auto:**

Kjo persupozon ngarkimin ne mjet te materialet e nxjera nga germimi i dherave te themeleve, dhe dergimin ne vendin e caktuar nga Bashkia.

#### **6.11.BETONI E B/ARMEJA**

(Sasia per 1m<sup>3</sup>)

Recepturat e betoneve qe do te perdoren ne objekt do te jene:

Beton marka 150 me inerte , konsistence 3-5 cm,granil deri 20 mm, rërë e lare me modul 2,6:  
Çimento 400 kg 260 , rërë e lare m3 0,44 , granil m3 0,70, uje m3 0,18.

Beton marka 200 me inerte , konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm,rërë e lare me modul 2,6:  
Çimento 400 kg 300 , rërë e lare m3 0,43 , granil m3 0,69 , uje m3 0,18 .

Beton marka 250 me inerte , konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm,rërë e lare me modul 2,6:  
Çimento 400 kg 370 , rërë e lare m3 0.43, granil m3 0,69 , uje m3 0,185 .

Beton marka 300 me inerte , konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm,rërë e lare me modul 2,6:  
Çimento 400 kg 465 , rërë e lare m3 0,38 , granil m3 0,64 , uje m3 0,195 .

Strukture mbajtese beton/arme parashikon:

Pjese godine me strukture mbajtese beton/arme, i ndertuar ne distance nga muratura, duke parashikuar nje fuge teknike ( $L=1/100h$ ). Struktura duhet te formohet nga skelet me trarë, kollona, plinta, Shkallë te lidhura ndermjet tyre dhe e realizuar:

Plinta, te realizuara dhe të armuara ne menyre te rregullt sipas udhezimeve ne projekt, me beton M-200, te hedhur në vepër ne shtresa te holla dhe të vibruara mire, me dozim sipas pikes siper, duke perfshire hekurin e armatures, kallepet, perforcimet, si dhe çdo detyrim tjeter dhe mjeshteri per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

Shkallë për çdo kat, formuar nga nje tra mbajtes i thyer dhe ne qender me themelet përkatëse, mbi te cilen do te ndertohen 20 shkallë te veshura ne pjesen e siperme me nje shtresë granili me ngjyre sipas D.P., e gjitha e dimensionuar ne menyre te rregullt dhe e armuar sipas udhezimeve ne projekt, dhe e realizuar me beton M-250, te vene në vepër ne shtresa te holla dhe të vibruara mire, me dozim sipas pikes siper, duke perfshire kallepet, perforcimet, puntelimet, skelat e sherbimit, gërmimet dhe themelet, hekurin e armatures si dhe çdo detyrim tjeter per te patur te perfunduar punen ne menyre perfekte.

Arkitrare te parapergatitur, furnizim dhe vendosje në vepër e arkitrarëve te parafabrikuar me kanal kullim shiu, me gjerësi totale deri 40 cm dhe seksione te ndryshueshme, te formuar nga beton M-300 sipas pikes 4.a.4, te armuar ne menyre te rregullt dhe sipas udhezimeve ne projekt, te vendosur në vepër me llaç cemento M-1:2 sipas pikes 3.a.5, duke perfshire armaturen e hekurit, punimet e muraturës si dhe çdo detyrim tjeter per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

Perfocimi i themeleve, betonimi, do te kryhet me beton te prodhuar ne kantier, do te transportohet ne vendin ku do te hidhet me kova, do te vibrohet me shtresa, ana e jashtne do te behet me armature ne forme pyke dhe do te mbushet 10 cm mbi tabanin e themelit ekzistues. Kjo krijon mundesine qe mbushja e nenthemelit te realizohet plotesisht.

Per rastet kur ato jane te drejta por kane tjegulla te tjera dhe kane levizur eshte parashikuar riberja e mbuleses e pila parashiko.

Uljen poshte te tjegullave, te cilat nuk parashikohen te riperdoren por do ti lihen investitorit, i cili edhe mund te vendose te riperdor. Ne kete rast supervizori do te kerkoje nga kontraktori analize kostoje.

Heqjen e listelave, te cilat nuk do te riperdoren, ato parashikohet te jene te reja prej pishe te staxhionuar dhe me permasat 40x50 mm

Kontrollin e struktures mbajtese, nivelimin e struktures duke e bere gati per vendosjen e listelave.

Vendosja e nje flete plasmasi te armuar tip MAUER e cili largon ujin qe mund te hyje ne rastet kur shiu bie me furtune. Plasmasi del deri ne strehe qe te mund te shkarkoje ujerat eventuale.

Tjegullat do te vendosen drejt, reshti duhet te jete perpendikular me murin. Tjegullat do te lidhen apo do te kapen me upa, nje resht po nje resht jo. Kulomoret duhet te lidhen me llac te perzier M-25 duke i perpunuar me shume kujdes buzet.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.

#### **6.12.Per catite e reja qe do te ndertohen mbi teracat ekzistuese parashikohet :**

Pastrimi i teraces, heqja e parapetit ekzistues dhe mandej realizimi i struktures mbajtese sipas vizatimeve dhe detajeve te dhena ne projekt. Derrast, binaret apo lenda qe do te perdoret per strukturen mbajtese detyrimisht duhet te jete e staxhionuar.

Nivelimi perfekt i struktures mbajtese te catise duke e bere gati per vendosjen e listelave.

Vendosjen e listelave ne pershtatje me hapin e tjegulles, listelat te jene te drejta. Bashkimi i tyre duhet te behet detyrimisht mbi strukturen mbajtese dhe jo ne hapesire.

Vendosja e nje flete plasmasi te armuar tip MAUER e cili largon ujin qe mund te hyje ne rastet kur shiu bie me furtune. Plasmasi del deri ne strehe qe te mund te shkarkoje ujrart eventuale.

Tjegullat do te vendosen drejt, reshti duhet te jete perpendikular me murin. Tjegullat do te lidhen apo do te kapen me upa nje resht po nje resht jo. Kulomoret duhet te lidhen me llav te perzier M25 duke i perpunuar me shume kujdes buzet.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.

#### **6.13.F.V e ulluqeve horizontal, vertikale dhe kasetave parashikon:**

Cmontimin e ulluket horizontale dhe vertikale te çatave dhe tarracave ne gjendje jo te mire duhet te cmontohen dhe të zevendesohen me ulluke te rinj.Ulluke horizontale dhe vertikale per shkarkimin e ujrave te catise dhe tarraces i perbere me plastike me dimensione 5x10. Ose me llamarine xingato me zhvillim 33 cm. Ne çdo ulluk duhet te

mblidhen ujrart e nje siperfaqe te çatise ose tarracës jo me te madhe se 50m<sup>2</sup>.

Ulluket vertikale duhet te vendosen ne pjesen e jashtme te nderteses me ane te qaforeve përkatëse prej celiku te xinguar, te fiksuar mbi parete çdo 2m. Ujrart e tarracës duhet te mblidhen nepermjet nje pjate plastike (prodhim i gatshem), te vendosur ne menyre te terthorte ndermjet muraturës dhe parapetit, me pjerresi 1%, dhe sipas udhezimeve ne projekt.

Ulluket horizontale duhet te vendosen ne pjesen e jashtme te nderteses me ane te qafore përkatëse prej celiku te xinguar, te fiksuar mbi elementet e struktures mbajtese por jo me larg se 110 cm. Ulluket duhet te vendosen me pjerresi per te cuar ujin e catise ne piken e shkarkimit vertikal te cilet vendosen ku percaktohet ne projekt

Pjesa fundore e ullukeve, per lartëhet te kaloje nen trotuar dhe te derdhet ne faqe te trotuarit. Gryka e ullkut duhet te betonohet me borduren e totuarit.

#### **6.14.Dysheme me pllaka gres parashikon:**

Pllakat do te jene te dimensineve 31.6x31.6, gres porcelanato nje brumeshe, jo luçidato. Ngjyra e tyre do te percaktohet nga supervizori. Pllakat do te jene «zgjedhje e pare» te verifikuara ne ambalazhim. Pllakat do te shtrohen me kolle, mbi nje siperfaqe grezo me llaç çimento pasi te jete verifikuar nivelimi i saj me nje proces verbal. Nivelimi te behet nga nje specialist topograf me nje tolerance jo me shume se 5mm ne te gjithë godinen. Pllakat do te shtrohen me fuga qe formojne nje kend 45 grade me akset e godines. Akset diagonale te pllakave duhet te jene rigorozisht paralele me akset e godines dhe shtrimi i tyre duhet te jete pa nderprerje nga koridori neper dhoma, pra fugat te jene ne vazhdimesi.

#### **6.15.Plintusat parshikon:**

Zokol plintusi ne qeramike me ngjyre te erret me lartësi 8 cm dhe trashesi 1,5 cm , i vendosur në vepër kolle duke perfshire stukimin, pastrimin si dhe çdo detyrim tjeter per mbarimin e plote te punes ne menyre perfekte.

#### **6.16.Suvatim i brendshëm parashikon:**

Sprucim i mureve dhe tavanaeve, me spruco çimentoje të lëngët te pergatitur me rere guri cimento dhe uje, për përmirësimin e gjitjes së suvasë dhe rforcimin e siperfaqeve te muraturës, duke perfshire skelat e sherbimit dhe çdo detyrim tjeter per ti dhene plotesisht fund sprucimit.

Suvatim i realizuar nga nje shtresë me trashesi 2 cm.

Llaçi bastard M-25 me dozim per m<sup>2</sup>: rërë e lare m<sup>3</sup> 0,005, llaç gelqereje M-1:2m<sup>3</sup> 0.03,

çimento 400 kg 6.6, uje, i aplikuar, me paravendosje te

drejtuesve ne mure, dhe e lemuar me mistri e berdaf, duke perfshire skelat e sherbimit si dhe çdodetyrim tjeter per ti dhene plotesisht fund suvatimit ne menyre perfekte.

#### **6.17.Suvatim i brendshëm ne rikonstruksione**

Sistemim i siperfaqeve ku eshte e nevojshme, per suvatime per nivelimet e parregullsive me ane te mbushjes me llaç bastard me me shume shtresa dhe copa tullash n.q.s. eshte e nevojshme, edhe per zonat e vogla si dhe çdo detyrim tjeter per ti dhene plotesisht fund stukimit.

Sprucim i mureve dhe tavanaeve per murature te pastruar, me llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe rforcimin e siperfaqeve te muraturës, duke perfshire skelat e sherbimit dhe çdo detyrim tjeter per ti dhene plotesisht fund sprucimit.

#### **6.18.Suvatim i jashtem me grafiato perfshin:**

- Aplikimin e grafiatos e cila pergatitet ne ngjyrat sipas kerkesave te projektit. Grafiato aplikohet mbi suvatimin e thjeshte te parapergatitur

- Skelat e sherbimit si dhe cdo detyrim tjeter per ti dhene plotesisht fund suvatimit ne menyre perfekte dhe cdo detyrim tjeter per ti dhene plotesisht fund xokolatures ne menyre perfekte

- Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit. Termoizolim fasade me sistem kapote perfshin:

Veshje fasade me polisterol jeshil t=5cm + rrjete + suva parashikon montimin e polisteralit jeshil me trashesi 5 cm, duke e ngjitur ate me kolle ne murin e fadases. Nderkohe perdoren dhe upa betoni plastike me gjatesi 10 cm. Montohet dhe fiksohet mire rrjeta pkastike e suvatimit, pasi te

jene perfunduar masat peragjitore behet suvatimi me grafiato I pergatitur me ngjyrat e parashikuara ne projekt.

Perfshihen skelat e sherbimit si dhe cdo detyrim tjeter per ti dhene plotesisht fund suvatimit ne menyre perfekte dhe cdo detyrim tjeter; garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

#### **6.19.Veshje me pllaka majolike**

Veshje për një lartësi 2 m te mureve, me pllaka majolike te bardha 20x20 cm te cilesise se pare, furnizuar dhe vendosur në vepër mbi nje siperfaqen e pergatitur me pare, e ngjitur me kolle, stukim me çimento te bardhe, pastrim i plote, skelat e sherbimit si dhe çdo detyrim tjeter per mbarimin e veshjes ne menyre perfekte.

#### **6.20.Punime bojatisje parashikon:**

Gerryerje dhe heqja e bojatisjeve te vjetra me gelqere te bardhe, boje etj. edhe me shume shtresa mbi mure dhe tavane, duke perfshire skelat sherbimit ose skelerine si edhe spostimin ne ambientin e kantierit.

Stukimin dhe lemimin e suvasë te rashinuar me pare me stuko sintetik per te patur te gatshme dhe ne menyre perfekte siperfaqet per lyerje.

Nje dore solucion lidhes e formuar me rreshire te holle me 50 % uje dhe e zbatuar me penel mbi mure dhe tavane.Bojatisje me tre duar, me qumesht gelqereje dhe ngjyra te ndryshme per mure te brendshëm, te

jashtëm dhe tavane dhe me dozature per m<sup>2</sup>: gelqere e shuar kg 0.55, pluhur ngjyre kg 0.01 si dhe çdo gje te nevojshme per mbarimin e plote te punes ne menyre perfekte.

#### **6.21.Dyer druri të brendshme per dhomat**

Siguroni dyer druri të tipeve, madhësive dhe të skicave të treguara në figurat.

Dyert e drurit te klasave dhe te mjediseve te tjera jane standarte, do te jene prodhim importi i gatshem, me kompesate lisi ne ngjyre natyrale. Fashaturat e dyerve te jene me gjeresi jo me pak se 10cm dhe te jene prej druri natyral, (jo EDF). Brava te jete me bukature dy pjeseshe dhe me celes automatik. Dyert e klasave do te kene dritare vezhgimi e cila lejon kontrollin e klases pa prishur procesin mesimor, hapja do te jete si ne skicat e projektit.

Llustra natyrale: Siguroni dyer të llustruara në fabrikë nga prodhuesi i dyerve si më poshtë: Veshja duhet të jetë AWI QS gjysëm e shkëlqyer, efekt i vijëzimeve të drurit të afërta. Ngjiti cepat, prerjet, ornamentet dhe aksesorët e drurit dhe aplikoni dy veshje me llustër, kompatibël me llustrën e faqes së derës. Jepini dorën e fundit llustrëave që mund të jenë gërvishur ose prishur ose kur vrimat e vidave janë mbushur, sipas instruksioneve të prodhuesit të dyerve. Përputhni ngjyrën dhe shkëlqimin e llustrës me atë të fabrikës duke përdorur materiale kompatibël për përdorim në vend.

Llustra e shtresave plastike: E aplikuar që në fabrikë, e tipit të përgjithshëm ose për qëllim specifik, me trashësi minimale 1.25 mm. Ngjitni me tutkall shtresën plastike për dyert tambura, tek rimesoja e drurit, kompensata ose tek mbështetsja e pasme, për të formuar panelin e derës. Trashësia minimale e shtresës plastike dhe mbështetses së bashku duhet të jetë 2.5 mm.

#### **6.22.Dyer te jashtme me xham**

Furnizim në vepër dere kryesore hyrjeje me xham, permasat e se ciles duhet te percaktohen nga ndermarja ne kantier, per variantin dyer druri duhet siguruar dru pishe te staxhionuar ne menyre



natyrale ose artificiale, i imprenjuar, e ndertuar nga : telajo e fiksuar, me seksion 6x4 cm e kompletuar me kllapa hekuri; dere me dy kanate, ku secili kanat, me skelet me seksion minimal 10x4 cm e lidhur ne fasho te ndermjetem horizontal dhe vertikal me seksion te njejte dhe nje fasho e poshtme me lartësi 25 cm , duke formuar dy korniza nga te cilat: nje e sipërme e realizuar me xham te forte me spesor mm.4 i bllokuar ne patenten e kornizes per fiksimin e xhamit me listella, mbi te cilen nga ana e jashtme do te fiksohen hekura me seksion kuadrat cm. 6,5x0,5, ne drejtimin horizontal, ne largesi nga njera tjetra cm, 23,5 dhe sipas udhezimeve te projektit dhe tjetri i poshtem i realizuar nga panele me dru pishe te staxhionuar ne menyre natyrale ose artificiale, i imprenjuar; e tera e kompletuar me te pakten dy mentesha te renda prej 16 cm për çdo kanat, me lloze mbajtes te inkorporuar ne strukturen prej druri, nje brave sigurie te madhe, e pajisur me tre celesa ,doreza alumini dhe piastrat e gojezat përkatëse me pllaka alumini, duke perfshire punimet e muraturës, skelat e sherbimit si dhe çdo detyrim dhe punim tjetër per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

Per rastin qe dyert e jashtme do te jene duroalumini do te plotesohen kerkesat qe vijojne ne pikat ku filitet per b kete lloj prodhimi.

#### **6.23.Pragje dritaresh me me mermer Pigon parashikon :**

Pragje e mermerit , me pike kullimi uji, te oerpunuar ne menyre te rregullt, te lustruara ne menyre perfekte dhe me trashesi 3 cm , gjerësi 40 cm dhe gjatësi sipas udhezimeve ne projekt, , duke perfshire çdo detyrim tjetër dhe mjeshteri per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

#### **6.24.Veshje e shkallëve me mermer parashikon :**

Celes 1 polar, 250V, 10 tipi brenda murit, ngjyra e bardhe, perfshin suportin, pllaken e furnizuar montuar dhe lidhur e kontrolluar. Llojet e ndricuesave jan sipas specifikimeve ne projekt.

IEC/EN 60669-1

## Çeles i thjesht



### Perdorimi


Kontrroll i ndricimit por dhe ngarkesave te tjera.

### Modele

#### Pershkrimi

Celes  
1P 10AX 250 V.a.c.

### Dimensionet ne (mm)



Celes	A	B	C	D
1 Modul	45.1	22.3	27	

### Lidhja

Tipi terminalit: me vide  
Kapaciteti terminalit: 2 x 4 mm<sup>2</sup> max  
Gjatesia e shtrengimit: 9 mm  
E pershtatshme per tela fleksibel ose unik

### Karakteristika teknike

#### - Shkalla e mbrojties IP

(Duke konsideruar nje instalim total bashke me kapak)  
Depertimi nga trupa solid/ujt: IP40

#### - Karakteristika mekanike

Mbrojtia nga goditje: IK 04

#### - Materiali i paisjes

- PC (Polycarbonate)  
- Kapaku estetik: ABS - ABS/PC (Polycarbonate)

Mbrojtje nga rrezatimi UV

Veteshuares

850° C / 30 s for insulating parts holding live parts in place  
650° C / 30 s for other parts made of insulating materials

#### - Karakteristika elektrike

Tenstioni: 250 V.a.c.

Rryma: 10A

#### - Karakterisitika klimaterike

Temperatura e ruajtjes: - 10° C to + 70° C  
Temperatura e perdorimit: - 5° C to + 35° C

### Pastrimi


Te pastrohet me nje rrobe

Te mos perdoren agjent gerryes gjate pastrimit.

### Standarte dhe aprovime

NE PERPUTHJE ME STANDARTIN

IEC/EN 60669-1.



Prize Shuko univrsale

#### Perdorimi

Priza per: Spina te standartit Italian / Gjerman


#### Modele

#### Pershkrimi

##### Shuko

Prize 2P+T 10A and 16A 250 Va.c. distanca midis kontakteve 19mm & 26mm, kontakti i tokes anesore; per spina 2 P dhe 2 P+T 10 and 16 A tipi Italian, per spina 2 P+T 10 and 16 A tipi Gjerman

#### Dimensionet ne (mm)



	A	B	C	D
<b>Shuko</b>	45.1	44.7	31.7	9.8

#### Lidhjet

Tipi terminalit: me vide  
Kapaciteti terminalit: 2 x 4 mm<sup>2</sup> max  
Gjatesia e shtrengimit: 11 mm  
E pershtatshme per tela fleksibel ose unik

#### Karakteristika teknike

**- Shkalla e mbrojtjes IP**  
(Duke konsideruar nje instalim total bashke me kapak)  
Depertimi nga trupa solid/ uji: IP20D

**- Karakteristika mekanike**  
Mbrojtja nga goditje: IK 04

**- Materiali i paisjes**  
Kapaku estetik: PC (Polycarbonate)

Pa cillrim halogjent

Mbrojtje nga rrezatimi UV

Veteshuares

850° C / 30 s for insulating parts holding live parts in place  
650° C / 30 s for other parts made of insulating materials

**- Karakteristika elektrike**

Tensioni: 250 V a.c.

Rryma: 10A / 16A

**- Karakteristika klimaterike**

Temperatura e ruajtjes: - 10° C to + 70° C

Temperatura e perdorimit: - 5° C to + 35° C

#### Pastrimi

Te pastruhet me nje rrobe

Te mos perdoren agjent gerryes gjate pastrimit.

#### Standarte dhe aprovime

NE PERPUTHJE ME STANDARTIN


- CEI23-58

- IEC 60884-1



## Prize RJ 45

TIA-568-C-2



### Perdorimi

Prize RJ45 per transmetim sinjali data/telefoni.

### Modele

#### Pershkrimi


RJ45 UTP cat5E me terminim pa nevojen e ndonje paisje

RJ45 UTP cat6 me terminim pa nevojen e ndonje paisje

RJ45 STP cat6 me terminim pa nevojen e ndonje paisje

RJ45 STP cat6A me terminim pa nevojen e ndonje paisje

### Dimensioonet ne (mm)




A	B	C	D
45	22.5	23.9	12.1

### Lidhjet

Pa nevojen e ndonje paisje.

Disa versione:

RJ 11 (4 kontakte), RJ 12 (6 kontakte), RJ 45 (9 kontakte)



EIA - TIA 568 A and B me dy kodime ngjyrash ne terminal:

- UTP 8 Kontakte
- FTP 9 Kontakte
- STP 9 Kontakte me skermo 360\*
- UTP 8 Kontakte
- FTP 9 Kontakte
- STP 9 Kontakte me skermo 360\*

Kabujt qe perdoren:

- Me nje berthame: 0.5 to 0.65 mm, AWG 22 to 25
- Me disa berthama: AWG 26
- Izolimi Polyethylene i percjellesit: Ø max. on 1.58 mm insulation




## RJ 45 socket


**TIA-568-C-2**

### Lidhjet

Prizat duhet te kene nje mekanizem bllokues ne moment lidhje, mundesi rilidhje ne rast lidhje gabim si dhe mundesi kabllimi pa qene nevoja e ndonje paisje shtese



Sistem qe lehtëson pune e instalatorit duke parafiksuar percjellesat ne kanalet perkates.



### Karakteristika teknike

#### - Shkalla e mbrojtjes IP

(Duke konsideruar nje instalim total bashke me kapak)  
Depertimi nga trupa solid/uj: IP40

#### - Karakteristika mekanike

Mbrojtia nga goditje: IK 04

#### - Materiali i paisjes

Kontaktet: flori/nikel, trrashesia e floririt > 0.8 µm (minimumi)

Pjeset metalike: bronz, nikel, platinum, flori

Polykarbonat PBT

Per prizat STP trupi i tyre dhjet te jete i perbere nga aliazh metal:  
veshje baker/nikel.

Materiali: ABS per mbulesen plastike

Pa clirim halogjeni

Mbrojtje nga rrezatimi UV

Veteshuares

850° C / 30 s for insulating parts holding live parts in place

650° C / 30 s for other parts made of insulating materials

#### - Karakteristika elektrike

Tensioni shpimit ≥ 1000 V

Rezistenca e kontaktit ≤ 20 MΩ

Rezistenca e izolimit ≥ 500 MΩ at 100 VDC

Konektori i certifikuar per stres nen sinjal POE, sipas standartit IEEE 802.3af dhe POE+ sipas standartit 802.3at, deri ne 2500 kycje/ckycje ngarkese.

Testet te jene kryer me alternim 2 qarqesh te ndryshem me ngarkese 50W.

#### - Karakteristika klimaterike

Temperatura e ruajtjes: - 10° C to + 70° C

Temperatura e perdorimit: - 5° C to + 35° C

### Pastrimi

Te pastrohet me nje rrobe

Te mos perdoren agent geryes gjate pastrimit.

### Standarte dhe aprovime

NE PERPUTHJE ME STANDARTIN

**TIA-568-C-2**



# Ndricules LED

## 600 x 600 mm



### Te dhena te pergjithshme

Ngjyra e drites	3000k / 4000k / 6000k
Burimi drites	I pa ndryshueshem
Menyra e furnizimit	Me ushqyes
Tipi i optikes	Me kend 120°
Klasa e mbrojtjes IEC	Klase mbrojtje II
Testi i shkrire se percjellesit	Temperatura 650 °C, kohezgjatja 30 s
Markimi CE	CE
Numri i paisjeve ne automat MCB 16A, kurba A /B	35
Faktori i fuqise (Min)	0.9

### Karakteristika elektrike

Tensioni i hyrjes	220 to 240 V
Frekuenca ne hyrje	50 or 60 Hz
Rymat e leshimit	15 A
Koha e leshimit	0.2 ms
Risku fotobiologjik	Nga 0 @ 200mm sipas EN62471

### Te dhena mekanike dhe ndertimi

Materiali karkases	Çelik
Materiali reflektues	Akriolat
Materiali optik	Polisterol
Lentja optike	Opale
Gjatesia	595 mm
Gjeresia	595 mm
Thellesia	35 mm
Ngjyra	E bardhe
Dimensionet (Lartesi x Gjeresi x Gjatesi)	35 x 595 x 595 mm (1.4 x 23.4 x 23.4 in)

### Performanca (KONFFORME IEC)

Fluksi i ndricimit	3400 lm
Toleranca e fluksit	+/-10%
Efikasiteti i ndricuesit	100 lm/W
Temperatura e ngjyres	3000K / 4000K / 6000K
Indeksi i ngjyres	>80
Fuqia ne hyrje	34 W
Toleranca e fuqise	+/-10%

### Performanca e jetgjatesise (KONFFORME IEC)

Jetgjatesia mesatare 50000 h

### Aplikimet

Temperatura e ambientit	+10 deri ne +35 °C
Temperatura ideale e ambientit	25 °C

### Dimensional drawing



# Plafon LED rrethor

## Perdorimi

- Ambientet e brendshme rezidenciale
- Tipi: I fiksuar ne tavan


Specifikime:

### Dizenjimi dhe ndertimi

- Ngjyra: E bardhe
- Materiali: Plastik
- Kendrite i orientueshem: JO
- Difuzor drite: PO
- I dimerueshem: JO
- Modul LED: PO
- Komandim remote: JO

### Karakteristika te drites

- Indeksi i pasqyrimet te ngjyrave (CRI): 80
- Karakteristika teknike
- Fuqia e çipit LED: 18W
- Jetegjatesia: 15,000 h
- Burimi i drites ekuivalent me nje burim drite tradicional prej: 24 W
- Diametri: 320 mm
- Totali i ndricimit ne dalje: 1300
- Teknologjia e modulit LED: 240 V
- Ngjyra e drites: 3000k / 4000k / 6000k
- Furnizimi me energjis: 220-240VAC
- I dimerushem: JO
- Teknologji LED: PO
- I ndertuar me ÇIP LED: PO
- Shkalla e mbrojties IP: IP20, mbrojtie nga objektet me te medha se 12mm, pa mbrojtie nga uji
- Klasi i mbrojties: I - i tokezuar



## 1. SISTEMI I NDRICIMIT TE EMERGJENCES

### a) Parametrat e projektimit

Sipas standarteve europiane:

- Rruget e daljes sipas DIN EN 1838
- Sistemi i baterise qendrore sipas DIN EN 50171, DIN EN 50172,
- Ndricimi emergjent sipas EN 60598-1, EN 60598-2-22

### b) Pershkrimi funksional

Korridoret do te jene e pajisur me sistemin e ndricimit emergjent sipas standarteve ne fuqi. Te gjitha produktet duhet te jene te pajisur me shenjen CE dhe furnizuar nga kompanite e certifikuara sipas ISO 9001. Sipas DIN EN 1838 minimumi i vazhdueshem i nivelit te ndricimit ne rruget e ikjes do te sigurohet qe te jete 1 lux. Fushat e meposhtme jane respektuar ne projektimin e sistemit te ndricimit emergjent:

- Rruget e daljes (korridoret, shkallet, etj.) dhe tabelat e daljes, ku duhet te arrihet ndricim prej 1 lux pergjate rruges se daljes;



- Zonat e hapura > 60m<sup>2</sup> kerkojne ndricim anti-paniku me nje ndricim minimal prej 0.5 lux
- Shkallet duhet te marrin drite te drejtperdrejte nga ndricuesit emergjent, ne menyre qe ndricimi minimal te jete 1 lux
- Ne cdo ndryshim te drejtimit duhet te jete i instaluar ndricim emergjent.

Sistemi i emergjencës është realizuar duke vendosur ne te gjitha korridoret, daljet jashtë dhe ne rruge kalimet ne rast evakuimi, te ndriçueseve te emergjencës për tregimin e drejtimit te daljes. Këto ndriçues janë me bateri, me autonomi 72ore.




Figura 1 : Ndricues evakuimi EXIT emergjence dhe kiti i baterisë

Specifikimet teknike te ndricuesit te evakuimit 8W:

- **Montimi:** Instaluar ne tavan / instaluar ne mur;
- **Burimi i drites:** LED;
- **Sistemi optik :** difuzor peciklas;
- **Sistemi i ndricimit:** Direkt;
- **Instalimi :** me kitin e baterise Ni-Cd (Mbrojtje e baterise nga mbingarkesa dhe Shkarkimet, tregues karikimi LED);
- **Ushqimi :** 220-240 V, 50-60 Hz;
- **Fuqia Instaluar :** 1x8W;
- **Bateria Ni-Cd:** 10.8V/3Ah
- **Fluksi i ndricimit** 30lm;
- **Shkalla e mbrojtjes:** IP 20;
- **Klasa mbrojtjes mek:** IK 07;
- **Pesha ndricuesit :** 1.2kg;
- **Dim.diameter:** 352 60 x 228 mm ;
- **Autonomia:** 3ore;
- **Jetegjatesia:** 100,000 ore pune, me eficence te larte.

Ndricuesit e emergjences dhe avarise duhet të jene me bateri Ni – Cd. Vendosja e tyre do të behet në mënyrë të tille që të sigurohet një shkalle ndriçimi prej 5lux, kurse pavarësia e funksionimit të tyre për ndërprerjen e rrjetit duhet të jete të paktën 3ore. Ndrçimi i sigurisë (shenjat e shkalleve, drejtimet e daljeve) do të jene me llamba LED 8W .

## 2. SISTEMI I DETEKTIMIT TE ZJARRIT

Sistemi Fire alarm ose mbrojtjes kundër zjarrit është një sistem që paralajmëron personelin për praninë e zjarrit ose të tymit në objekt. Me poshtë jepen referencat e standardeve që janë marrë në konsideratë gjatë hartimit të projektit të sistemit të detektimit të zjarrit.

Këto i referohen:

- *Ligjet dhe normat e aplikuara ne Shqipëri*
- *Normat evropiane*

EN 54	Sistemi i detektimit dhe alarmit të zjarrit
ISO 7240	Sistemi i detektimit dhe alarmit të zjarrit, kërkesat e sigurisë
ISO 8421-3	Mbrojtja ndaj zjarrit
BS 5839	Sistemi i detektimit dhe alarmit të zjarrit për ndërtesat

Ky sistem përbehet nga:

- Centrali i alarmit të zjarrit;
- Detektorët e tymit;
- Pulsantët manual të thirrjes së zjarrit;
- Sirenat e brendshme;
- Kabllot e lidhjes të loop-eve të detektoreve dhe sirenavë;

**Pajisjet e kontrollit.** Kontraktori duhet të mbulojë, instalimin, testin, lidhjen dhe garanton një cilësi të lartë të veprimit të pajisjes sinjalizuese të zjarrit dhe sistemit të alarmit duke përfshirë dhe autoparlantet, ndriçuesit, pajisjet e alarmit, kontaktet e thyerjes së xhamit, panelet e alarmit të zjarrit, karikuesin e baterisë, dhe releve të shoqëruar, do sigurohen dhe lidhen në përputhje me specifikimet, sipas pozicioneve të treguara në vizatime.

Sistemi i sinjalizimit të zjarrit për të gjithë ambientet e godinës është projektuar në përputhje të plote me kërkesat e standardit BS 5891-1, (British Standard-Standardi Britanik i projektimit të sistemeve të sinjalizimit të zjarrit) ku:

- Centrali i alarmit të zjarrit (C.A.Z) është me 1 loop-e, i tipit konvencional, kategoria Lz, me modul komunikimi RS-232, me porte interneti, kartë konfigurimi, me regjistrim ngjarjesh, i programueshem dhe me bateri për 72 orë pavarësi dhe duhet të jetë i pajisur me ekran LCD.

Në figurën 34 tregohet një central anti-zjarr.



Figura 2 : Central alarmi zjarri konvencional

- Detektorët e tymit do të instalohen të tipit multi-sensitivë



Figura 3 : Detektore tymi/ multisensitive

- Pulsantët manual të alarmit të zjarrit, të vendosur në lartësi H=+1.4m nga dyshemeja.



Figura 4 : Pulsant manual zharri dhe llambe sinjalizuese

- Sirenat e alarmit te zjarrit, me intesitet 120 dB. Sirenat e alarmit te zjarrit ne ambjentet e brendshme vendosen ne lartesine H=+2.1m nga dyshemeja.



Figura 5 : Sirena alarmi zjarri

Sirenat e brendshme dhe te jashtmet duhet te jene konvencional te cialt do te lidhen ne sistemin analog te Loop me nje modul qe konverton linjen analoge ne konvencionale. Ky sistem duhet te perdor kabell kundra zjarrit, i kuq me seksion 2x1.5mm<sup>2</sup> dhe duhet te perdoren tuba rigid ne raste instalimesh te jashtme ose tuba fleksibel te rende per ato instalime qe jane te brendshme ne mure.

*Sinjalizuesit e tymit.* Keto do te veprojne ne menyre qe te mbajne ekulibrin ndermjet dhomes se hapur dhe te mbyllur, keshtu kur tymi deperton ne dhomen e hapur ai do te kete kontakt me qarkun dhe do te aktivizojë sinjalin. Çdo sinjalizues do te projektohet ne menyre qe te mbuloje nje zone prej 100 m<sup>2</sup>.Te gjithë sinjalizuesit e tymit, te jene instaluar te tilla qe te mund te nderrohen me zevendesues.



Rr. Gjik Kuçali  
Pll.23/2 Shk.1,Ap.1 Kati 1, Tirana  
+355 4 2456016  
shpk.taulant2@gmail.com



MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE  
MBROJTJES SOCIALE DHE NJËSITË  
VENDORE TË SHËNDETËSISË

## RELACION TEKNIK

**Objekti: "Projekt preventiva për rikonstruksimin e disa qendrave  
shëndetësore & ambulancave, për vitin 2023-2024 (Loti 2)"  
QENDRA SHENDETESORE PILUR**

**VENDI NDERHYRJES:PILUR/DEVOLL**

**POROSITËS: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale  
si dhe njësitë vendore të shëndetësisë**



**KONSULENT: "TAULANT" SH.P.K**



## PERMBAJTJA

**HYRJE.....3**

**1. NJESIA ADMINISTRATIVE PILUR -QARKU KORCE.....ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.**

**1.1 QENDRA SHENDETESORE PILUR..... ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.**

**1.1.1 Pozicioni I qendres shendetesore .....Error! Bookmark not defined.**

**1.1.2 Pamje e gjendjes aktuale te qendres shendetesore .....Error! Bookmark not defined.**

**1.1.3 Planimetria e qendres shendetesore.....Error! Bookmark not defined.**

**1.1.4 Pershkrimi i gjendjes ekzistuese te qendres shendetesore dhe ambienteve te sajError! Bookmark not defined.**

**1.1.5 Identifikimi i nevojave te qendres shendetesore per rehabilitim .....Error! Bookmark not defined.**

## HYRJE

Shërbimi parësor në vendin tonë është bazuar në funksionimin e qendrave shëndetësore dhe ambulancave (njësive shëndetësore) të ngritura në nivel të njësive administrative perberese të bashkive (njësi bashkiake, ish-komuna). Ky shërbim është publik dhe infrastruktura e tij është ngritur në bazë të respektimit të standardeve kombëtare të aprovuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Janë 421 qendra shëndetësore që funksionojnë si njësi autonome në qytet dhe në fshat, të cilat janë kontraktuar për shërbimet shëndetësore që ofrojnë nëpërmjet skemës së detyrueshme të sigurimit shëndetësor.

Në pjesën më të madhe të vendit, QSh është një organizim, që përfshin disa ambulanca. Ambulancat në qytete dhe në fshatra (ose njësi shëndetësore) janë mesatarisht 3-4 për çdo qender shëndetësore dhe janë të varura nga ana administrative nga qendrat shëndetësore. Personeli i QSh (ku përfshihen dhe ambulancat) përbëhet nga mjekë, infermiere, mami dhe personel mbështetës. Pra, shërbimet e kujdesit shëndetësor nuk ofrohen në një godinë të vetme, por nëpërmjet një rrjeti ofruesish të shërbimeve shëndetësore, të cilët punojnë afër komuniteteve. Çdo njësi administrative ka detyrimisht një QSh dhe çdo fshat ka një ambulancë ku shërben të paktën një infermiere.

Mesatarisht, çdo QSh i shërben një popullatë prej 8,000 –10,000 vetësh (kjo shifër luhet ndjeshëm në zonat urbane dhe rurale), duke patur një raport mjek/pacient rreth 1 me 2500 dhe raport infermiere/pacient rreth 1 me 400 banorë. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2023 ka ndërmarrë iniciativën për realizimin e projekt-preventivave të zbatimit për disa objekte të shërbimit parësor (qendra shëndetësore dhe ambulanca) në disa rajone, objekte për të cilat u realizuan projektet gjatë vitit 2015, vit kur Ministria realizoi investimin për projekt preventivat e qendrave shëndetësore dhe ambulancave në 10 qarqe.

Gjatë vitit 2018 MSHMS realizoi procedurën e prokurimit për rikonstruksionin e 67 objekteve qsh/amb në të gjithë vendin, por gjatë zbatimit të punimeve hasi në disa vështirësi, si degradim të situatës së infrastruktures së objekteve, disa lloj punimesh ishin harruar të parashikoheshin në preventiv, etj. Për këto arsye dhe për arsye të tjera si permbytje, termetet e viteve të fundit, degradim i situatës etj, u arrit në përfundimin që projekt preventivat e realizuara në vitin 2015, që janë përzgjedhur për rikonstruksion gjatë vitit 2023 të rishikohen për t'u përmirësuar.

### **1. OBJEKTIVI I DETYRES SE PROJEKTIMIT.**

Objektivi i kësaj Detyre Projektimi është vlerësimi ekonomik-teknik i çdo godine që ka nevojë për ndërhyrje. Qëllimi është:

- Te paraqesë të dhëna dhe të propozojë zgjidhjen më të mirë të mundshme bazuar në mundësitë e shfrytëzimit nga ana e institucionit.
- Te paraqesë kërkesat për një funksionim normal dhe dinjitoz si një godinë shëndetësore
- Të paraqesë kërkesat për një godinë institucioni me vlera bashkëkohore dhe funksionale.

### **2. REZULTATET E PRITSHME NGA OFRUESI I SHËRBIMIT.**

Ofruesi i shërbimit të rishikimit të projekteve, do të paraqesë si produkt të tij në përfundimin e kontratës, projektin e plote, specifikimet teknike, grafikun e punimeve për çdo objekt - qender

shendetësore/ambulance që ka nevojë për rikonstruksion.

Në listën bashkangjitur janë paraqitur të gjitha qendrat shëndetësore dhe ambulancave, e perzgjedhura shoqeruar me sipërfaqet e tyre, si dhe vendndodhja e tyre. Nga ana e njesive vendore të kujdesit shendetesor, është bërë një evidentim sipërfaqësor i gjendjes fizike të tyre, shoqeruar me foto, nisur nga mungesa e stafit teknik në këto drejtori. Për këtë arsye në kemi përgatitur një detyrë projektimi të përgjithshme. Ofruesi I shërbimit me të cilin do të lidhet kontrata, do të duhet të verifikojë vetë gjendjen e secilës godinë (sipas qarqeve) dhe nëse është e domosdoshme/e nevojshme, do të bazohet të kjo detyrë projektimi si dhe të projektet e para për të realizuar projekt preventivin e zbatimit

## 1. Njesia administrative PILUR - Bashkia DEVOLL

### 1.1. Qendra shendetësore PILUR

#### 1.1.1. Pozicioni I qendres shendetësore

Qendra shendetësore gjendet në fshatin **Pilur**, në pozicionin e dhënë në figurën e mëposhtme:




Fig.1.1 Pozicioni në plan I qendres shendetësore

#### 1.1.2. Pamje e gjendjes aktuale të qendres shendetësore

Pamje te gjendjes se qendres shendetesore **PILUR** nga jashte dhe brenda jane prezantuar nepermjet fotove te meposhtme:



Fig. 1.2 Pamje te qendres shendetesore nga jashte dhe brenda nepermjet fotove







### 1.1.3. Planimetria e qendres shendetesore

Ne plan qendra shendetesore ka nje siperfaqe te pergjithshme prej 35 m<sup>2</sup> dhe perbehet nga 2 dhoma vizitash, 1 tualet dhe korridor .Lartesia e katit eshte 2.90m.

Ne skicen ne vijim jepen planimetrit e pergjithshme e qendres shendetesore dhe ambienteve te saj



Planimetria egzistuese



Planimetria e propozuar

Fig. 1.3 Planimetria e pergjithshme e qendres shendetesore dhe ambienteve te saj

### 1.1.4. Pershkrimi i gjendjes ekzistuese te qendres shendetesore dhe ambienteve te saj

#### a) Gjendja e strukturave mbajtese



Ne pergjithesi jane ne gjendje te mire te qendrueshme gje qe ben te mundur vazhdimesine e punes ne objekt.

**b) Gjendja e fasades se jashtme**

Fasada e ka nevojte per nderhyrje. Xokoli I Objektit relativisht ne gjendje konstruktive te mire, me demtime te lehta te cilat mund te riparohen normalisht. Vihet re qe ne objekt mungojne teresisht trotuaret ne te gjithë perimetrin e godines. Ambienti per rreth objektit eshte ne gjendje te pa sistemuar. Mungon rruga hyrese per ne qendren shendetesore (pa shtruar pa sistemuar), si dhe rampa per njerezit me aftesi te kufizuara nuk egziston, duhet ndertuar.

**c) Gjendja e ambienteve te brendshme te qendres shendetesore**

**i. Muret e brendshme**

Jane te qendrueshme mure me tulle ,me suvatime te vjetera, me lageshti dhe fryerje te pjesshme , plasaritje te lehta.

**ii. Instalimet hidrosanitare dhe sistemi i furnizimit te jashtem me uje dhe shkarkimit te ujrave te perdorur:**

Sistemi I furnizimit te jashtem me uje behet nga rrjeti I fshatit ,rrjeti I amortizuar, rrjeti I shperndarjes se ujit te pishem ne godine eshte I amortizuar me tuba te vjeter, gjendja e pajisjeve hidrosanitare te prishura ka nevojte per rikonstrukcion. Sistemi I tubacionit te ujrave te perdor eshte I vjeter dhe shkarkimi I tyre eshte ne Grope septike.

**iii. Instalimet e brendshme elektrike dhe furnizimi I jashtem me energji elektrike**

Rrjeti elektrik vjen nga shtylla kryesore me kabull te demtuar saktesisht nga shtylla ne rrugen kryesore ne krah te godines, me largesi 15-20m nga shtylla me e afert deri tek qendra shendetesore. Rrjeti i brendshem me instalime eshte i vjeter dhe i amortizuar se bashku me pajisjet dhe aksesoret elektrike duhet riparuar.

**iv. Dyshemete**

Dyshemeja ka lageshtire eshte e shtruar me pllaka te vjetera, funksionale.

**v. Dyer dritare**

Dritaret dhe dyert jane duralumine ne gjendje jo te mire.

**vi. Sistemi i ngrohjes dhe kondicionimit**

Mungon sistemi I ngrohjes dhe kondicionimit .

**1.1.5. Sistemi I mbrojtjes kundra zjarrit**

Sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit mungon .

### ***1.1.6. Identifikimi i nevojave të qendres shëndetësore për rehabilitim***

Bazuar në gjendjen ekzistuese të qendres shëndetësore PILUR, diskutimi me punonjësit e saj dhe kërkesave standarte që duhet të plotësojë një qendër shëndetësore kemi identifikuar dhe listuar nevojat e mëposhtme për ndërhyrje rehabilituese:

- ***Ndërhyrje strukturore***

Pozicioni dhe funksioni i dhomave në Ambulance nuk do të ndryshojë.

- ***Rehabilitime në catine/soleten e qendres shëndetësore***

Ndërhyrja për riparimin e soletës është e domosdoshme në këto objekte. Të bëhet riparimi dhe hidroizolimi i soletës. Të vendoset kaseta shkarkimi me llamarine xingat. Të vendoset ulluk shkarkimi horizontal dhe vertikal me llamarine xingat.

- ***Rehabilitime në fasaden e jashtme të qendres***

Fasada e godinës do të bëhet pa ndryshuar volumnin, por duhet të bëhet i mundur trajtimi estetik, termoizolues dhe hidroizolues sipas standarteve dhe materialeve bashkëkohore, i cili të jetë në përputhje të plote me qëllimin dhe funksionalitetin e godinës. Rikonstrukcioni i Xoklatures dhe hidroizolimi i saj.

- ***Punime ndertimi rehabilituese në ambientet e brendshme***

Të bëhet suvatimi i ambjenteve të brendshme dhe të bëhet lysterja me boje hidroplastike.

Gjithashtu do të bëhet veshje me pllaka e sipërfaqeve të mureve që e kanë të domosdoshme të vishen si, mbi lavamanë të vecuara, në ambientet e punës. Rikonstrukcioni i plote i Tualetëve si dhe hidroizolimi i tyre.

- ***Punime të furnizimit me ujë dhe shkarkimit të ujrave të ndotura dhe hidrosanitare***

Furnizimi me ujë të bëhet nga rrjeti ekzistues i fshatit. Do të lidhet me rrjetin e ujesjellesit me tub PPR d=40mm, PN 16. Do të instalohet një depozite 500 litra. Tubacionet e furnizimit me ujë brenda godinës do të jenë PP-R, si për ujin e ngrohtë ashtu dhe për ujin e pijshëm. Uji i ngrohtë do të furnizohet nga boileret e vendosur në nyjet sanitare. Tubacionet për shkarkimet do të jenë PVC me diametër Ø 50 mm dhe Ø 110, rezistente ndaj korrozionit. Do të vendoset dhe puseta e shkarkimit b/a, 50 x 50 cm, h = 100 cm. Shkarkimet të bëhen në kanalizimin ekzistues të fshatit.

- ***Punime të brendshme dhe të jashtme elektrike***

Rikonstruksion i rrjetit brendshem elektrik. Zevendesimi i pajisjeve dhe aksesoreve me te rinj.Kaseta elektrike me mates do te vendoset ne korridor ndersa furnizmi me energji do te behet i mundur nga rrjeti ekzistues. Te behen ne cdo ambient pune linjat e internetit dhe priza interneti qe do te lidhet me serverin kryesor. Baze per percaktimin e pozicionit te prizave te cdo lloji do te jete plani i mobilimit.

- *Punime te mbrojtjes kundra zjarrit*

Duke patur parasysh siperfaqen e vogel te ambienteve si dhe siperfaqen e gjithë objektit per mbrojtjen nga zjarri jane parashikuar te vendosen 2 fikse zjarri 2kg si dhe vendosja e tabelave orientuese per daljen e emergjences.

- *Punime te tjera te nevojshme*

Te vendoset njesia e brendshme murale ne Ftohje -Ngrohje

Te rregullohet trotuari perreth godines. Te behet sistemim rregullim dhe gjelberim i ambientit para dhe rreth objektit. Te vendoset streha dhe rampa ne hyrje te ambulances si rampa ne dalje te emergjences, Tabela me emrin e ambulances si dhe tabela treguese te sinjalistikes si ne hyrje te godines ashtu dhe brenda godines per sherbimet qe jepen aty.



Rr. Gjik Kuçali  
Pll.23/2 Shk.1,Ap.1 Kati 1, Tirana  
+355 4 2456016  
shpk.taulant2@gmail.com



MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE  
MBROJTJES SOCIALE DHE NJËSITË  
VENDORE TË SHËNDETËSISË

## RELACION TEKNIK

**Objekti: "Projekt preventiva për rikonstruksionin e disa qendrave  
shëndetësore & ambulancave, për vitin 2023-2024 (Loti 2)"**  
*"Qendra shëndetësore dhe ambulanca Pilur, Devoll "*

**POROSITËS: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**  
**si dhe njësitë vendore të shëndetësisë**



**KONSULENT: "TAULANT" SH.P.K.**

## PERMBAJTJA

<b>1. TE PERGJITHSHME .....</b>	<b>3</b>
<b>2. FURNIZIMI ME ENERGJI ELEKTRIKE I OBJEKTIT .....</b>	<b>3</b>
<b>3. SISTEMI I RRJETIT TE FUQISE .....</b>	<b>4</b>
<b>3.1 Kuadri elektrik kryesor.....</b>	<b>4</b>
<b>3.2 Automatet mbrojtës .....</b>	<b>4</b>
<b>3.3 Prizat e Fuqise .....</b>	<b>5</b>
<b>3.4 Lloji i percjellsave dhe kablllove te perdorur .....</b>	<b>5</b>
<b>4. RRJETI I NDRICIMIT .....</b>	<b>7</b>
<b>5. SISTEMI I TOKEZIMIT MBROJTES .....</b>	<b>7</b>
<b>6. SISTEMI I MBROJTES ATMOSFERIKE, RRUFEPRITESIT.....</b>	<b>7</b>
<b>7. Normat, ligjet dhe rregullat .....</b>	<b>7</b>

## 1. TE PERGJITHSHME

Rrjeti elektrik ekzistues nuk shfrytezohet. Per hartimin e projektit elektrik te "Qender shendetesore dhe Ambulance" duhet te perdoren vetem produkte e material te certifikuar "CE ", produkte te standarteve te Bashkimit Europian, per te ndertuar keshtu nje objekt sa me funksional ashtu edhe bashkekohore, si edhe duke plotesuar normat e sigurise ne perputhje me normat e bashkimit europian, ne perputhje me funksionalitetin e objektit. Ne ndertimin e ketij objekti do te perfshihen ndertimi i sistemeve elektrike te meposhtme:

1. *Projekti i rrjetit te fuqise*
2. *Projekti i ndricimit*
3. *Projekti i tokezimit mbrojtës*
4. *Projektet skemave te kuadrove elektrike*

Projektimi i sistemit elektrik për objektin është projektuar në përputhje të plotë me strukturën e saj ndërtimore, arkitektonike dhe konstruktive, duke ju përshtatur dhe përgjigjur kërkesave të parashtruara në detyrën e projektimit. Ndërtimi i sistemit elektrik do të lidhet ngushtë me hapësirën e Ambulances

Përcaktimi i ngarkesave elektrike të vendosura është bërë sipas projektit, ndërsa i atyre të prishme duhet të bëhet në përputhje me rekomandimet që jepen në literaturë si edhe sipas përvojës së objekteve të tjera të ngjashme.

## 2. FURNIZIMI ME ENERGJI ELEKTRIKE I OBJEKTIT

Per furnizimin me energji elektrike te godines, do te behet nga rrejtja ekzistues me i afert .Kablli i furnizimit tipi FG16OR S=3x6mm2nga pika e lidhjes do te drejtohet per ne kuadrin elektrik kryesor te vendosur sipas pozicionit te percaktuar ne projekt.

Për të realizuar këtë sistem është llogaritur fuqia e instaluar dhe e kërkuar dhe janë bërë llogaritjet për furnizimin e te gjitha ngarkesave elektrike të objektit dhe ngarkesat për prizat dhe ndricimit dhe bollierve te ujit dhe kondicionereve.

Tabela e llogaritjeve te ngarkesa elektrike te instaluara ne objekt eshte:

1. <b>Fuqia aktive e instaluar Kuadri kryesor</b>	<b><math>P_{inst} = 11 \text{ kW}</math></b>
2. <b>Fuqia llogaritese e kerkuar</b>	<b><math>P_{kerk} = 5 \text{ kW}</math></b>
3. <b>Koeficienti i Kerkeses</b>	<b><math>K_{kerk} = 0.5</math></b>

Linja e kryesore e furnizimit ne godine, do te realizohet me kablllo FG16OR me seksion S(3x6)mm2.

### 3. SISTEMI I RRJETIT TE FUQISE

#### 3.1 Kuadri elektrik kryesor

Kuadri elektrik kryesor do të jete tip plastik, i instaluar brenda murit dhe të shkalles së mbrojtjes IP-40 i cili do te instalohet ne pozicionin sipas projektit. Kuadri elektrik kryesor duhet të jenë me hapsirën e nevojshme për vendosjen e të gjithë automatëve dhe të llogariten me një rezervë për zhvillime të mundshme në të ardhmen.

Kuadri te jete me dere transparente duke lehtësuar punën mirëmbajtës, të jenë të plotësuar me aksesorët e nevojshme për sigurinë e kabllimit dhe të gjithë pajisjeve të tjera. Një Kuader i tille i tillë lehtëson punën e automatëve nëpërmjet qarkullit të brendshëm të ajrit dhe bën të mundur një shpërndarje të automatëve sipas fazave të ndryshme dhe kërkesave të objektit.

***Kuadri Elektrik Shperndares*** i vendosur ne objekt si ne projekt:

- Me automat kryesor ne hyrje te kuadrit,  $I_n=25A$ , 1~ 230V/ 50Hz,
- Linje kryesore furzimi : FG16OR S=3x6mm<sup>2</sup>
- Hyrjet dhe daljet e kablllove jane nga poshte;
- Panel klemash per lidhjen e te gjithe kablllove hyres dhe dales;
- Shkalla e mbrojtjes: tip plastik, brenda murit murit IP 40;
- (sipas skemes qe jepet ne projekt )

#### 3.2 Automatet mbrojtës

Pajisjet mbrojtëse duhet të jenë automatë sipas normës CEI 60898 dhe CEI 60947-2. Këta automatë mbrojnë pajisjet dhe sigurojnë një veprim të shpejtë nga mbingarkesa dhe lidhjet e shkurta.

Automatët diferencialë dhe MT diferencialë sipas normës CEI 61008, sigurojnë përveç mbrojtjes nga mbingarkesa dhe lidhjet e shkurtra edhe mbrojtjen nga rrymat e rrjedhjes me tokën. Në këtë mënyrë sigurojnë personelin nga ndonjë gabim i mundshëm gjatë instalimit dhe gjatë dëmtimit të pajisjeve të cilat kanë kontakt direkt me të.

Pajisjet mbrojtëse nga mbitensionet sipas normës CEI 61643, shërbejnë për të mbrojtur sistemin elektrik nga mbitensione të paparashikuara të ndodhura nga goditjet e rrufeve apo edhe të atyre goditjeve që vijnë nga vetë rrjeti shpërndarës OSHEE gjatë komutimeve të ndryshme dhe gjatë defekteve të rënda në pajisjet transformuese.



### 3.3 Prizat e Fuqise

Te gjitha prizat, jane te tipit 16A/10A Priza shuko. Ato duhet te kene montim brenda ne kutin 3M/4M brenda murit. Prizat jane 230V, 16A, me tokëzim .

Instalimet elektrike te fuqise do te jene te brendshme me tub PVCØ25, si edhe ato qe kalojne ne mure. Linjat e furnizimit jane me tre percjelles (kafe = faze, blu = nul, e verdhe/jeshil = tokezim ). Karakteristikat e automateve duhet te zbatohen rigorozisht sipas klasit A. B. C. D. karakteristika termike e momentit te inercise ) per te garantuar selektivitet. Percjellesit qe do te perdoren do te jene fleksibel antifiami. Instalimi i elementeve do te behet si me poshte:



Figura : Prize shuko universale

### 3.4 Lloji i percjellsave dhe kabllave te perdorur

- Përshkrim i përgjithshëm

Përcjellësat dhe kabllot duhet të kenë kërkesa të larta për tipin e izolimit, mbështjelljes, dhe përcjellësve të specifikuar. Tipi izolimit duhet të jetë rezistent ndaj lagështirës dhe nxehtësisë, i përshtatshëm për temperaturë pune maksimale.

Kthesat (përkuljet) e kabllave nuk duhet të jenë me pak sesa ato të specifikuara nga prodhuesi për tipin e kabllit të specifikuar. Të gjithë përcjellësit duhet të jenë prej bakri. Ato duhet të jenë të plotë siç kërkohen. Seksionet minimale të përcjellësve: të gjitha prizat: 2.5mm<sup>2</sup>/ instalimet e të ndriçimit 1.5mm<sup>2</sup>, 400V/230V, Kodi me ngjyra:

- Fazë: E zezë, gri, kafe (kabllot)
- Fazë: E zezë (telat)
- Neutri: Blu e lehtë
- Tokëzimi mbrojtës: Verdhë/jeshile (shirita)

Kabllot e përdorur do të jenë të tipit FG16OR, sipas normës CEI 20-13, kabëll fleksibël bakri me izolim PVC, veshje të jashtme me material termoplastik të kualitetit M1 ngjyrëjeshile, HF me lëshim shumë të ulët të gazrave toksike..

Kablllo FG16OR është kablllo fleksibël, i izoluar, me mburojë të endur, të përberë prej përcjellësish me bakër të kuq, me mbrojtje PVC, antikorroziv dhe pa halogjen. Është i përshtatshëm për transmetimin e fuqisë dhe kontrollin e fuqisë në industri dhe ndërtime. I përshtatshëm për instalime fikse të brendshme dhe të jashtëm, instalime në ura, në tuba, etj.

#### 4.RRJETI I NDRICIMIT

Per te gjithë ambientet është bere llogaritja e intensitetit te ndricimit. Mbeshtetur ne standardin european EN 12464 është parashikuar vendosja si dhe numri i ndricueve ne ambient, me qellim arrijten e intensitetit te ndricimit te nevojshem.Sipas EN 12464 duhet te respektohet me rigorozitet fuqia e ndricimit sipas ambjeneteve.Me poshte është i paraqitur tipi e ndricueve te perdorur: Ndricues Plafon i jashtem Led, 34W, 4000K IP20.



Tipi 2 Plafon D=15.5cm ,18W,4000K IP44



Tipi 3 Spot rrethot,30W,4000K IP43 D=21

## 5.SISTEMI I TOKEZIMIT MBROJTES

Impianti i tokezimit mbrojtës përbehet nga 3 elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar  $H=1.5$ , të ngulura 2.5m larg njëra-tjetres. Elektrodat e tokezimit lidhen me përçuesve PE të seksionit  $S.16\text{mm}^2$ , i cili i pa shkeputur lidhet në secilen morsete të elektrodës dhe me pas drejtohet për tek shkeputesi i tokezimit.

Shkeputesi i tokezimit, shërben për shkeputjen e impiantit të tokezimit për të bërë të mundur matjen vlerës së rezistencës së tokezimit. Nga shkeputesi i tokezimit me përcjelles të veshur me  $S.1 \times 6\text{mm}^2$  shkon tek kuadri elektrik kryesor të vendosur në korridorin të objektit.

Me këtë përcjelles tokezimi do të tokezohen të gjitha paisjet mekanike, elektrike, si dhe panelet elektrike. Rezistenca e tokezimit pas matjes nuk duhet të rezultojë me e madhe se  $2\Omega$ .

Në qoftë se pas matjeve rezistenca e tokezimi është me e madhe se  $2\Omega$ , atëherë duhet të shtohet numri i elektrodave të tokezimi, derisa ky kusht të plotësohet.

## 6. SISTEMI I MBROJTJES ATMOSFERIKE, RRUFEPRITESIT

Sistemi mbrojtës nga mbritensionet dhe shkarkimet atmosferike të objektit (LPS) përbehet nga pritesat, zbritesat dhe tokezuesat.

Pritesi ndërtohet nga shufra metalike Fe-Zn  $\varnothing 16$  me gjatësi 1.5m, .Lidhja e pritesit realizohet si në vizatim me shirit të zinkuar  $30 \times 3$  mmn të kapur me morseta bashkuese. Zbritesat realizohen me shirit të zinkuar  $30 \times 3$  mmn të cilët kalojnë nga tarraca deri në tokezuesi në pusete.

.Gjatësia e zbritesave llogaritet të jetë pa keputje nga catia deri në pusetat përkatëse..

Tokezuesit realizohet me elektrodë të zinkuar me gjatësi 1.5m. Për nguljes së elektrodës në toke, hapet një gropë me thellësi 1,5m dhe në të ngulet elektroda në mënyrë që thellësia e saj të arrijë deri në 2m.

Në morsetat e tokezuesave lidhet përcjellesi i tokezimit i cili shkon në puseten ku ka arritur zbritesa dhe aty behet lidhja me morseteri.

Rezistenca e tokezimit në kohë të thatë duhet të jetë me e vogël se  $2\Omega$  (vlera e matur për një elektrodë të vetme të shkeputur nga sistemi) .

## 7.Normat, ligjet dhe rregullat

### - *Te pergjithshme*

Hartimi i Projektit elektrik bazohet në standartet dhe normat në fuqi të Republikës së Shqipërisë. Norma dhe standarte të njohura dhe të aprovuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS).

Objekti kategorizohet si ndërtesë administrimi (civile) dhe si i till do të trajtohet në këtë projekt. Instalimet duhet të bëhen në mënyrë strikte siç kërkohen nga normat SSH në fuqi. Karakteristikate impianteve dhe komponentëve të tyre duhet të jenë në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Instalimet duhet te permbushin kerkesat e OSHEE dhe kompanise IT (ISP) për nderlidhjen me sinjal telefonik dhe data.

Karakteristikat e pajisjeve, komponentëve dhe materialet e nevojshme për të përfunduar punimet,duhet te jenë në përputhje me karakteristikat e treguara ne kete dokument, duke respektuar ligjet,rregulloret dhe normativat (CEE, UNI, EN, ISO, INAIL, CEI).

Të gjitha materialet dhe furnizimet të jene te pajisura mundësisht me shenjën e cilësisë në përputhje me UNI EN ISO 9001 dhe / ose produkte të certifikuara nga organizata, dhe , ndonëse të dobishme, kanë CE shënuar sipas Direktivave te KE 392/89, të ndryshuar, dhe të jenë në përputhje me dispozitat e dekretit legjislativ Nr 81/2008 në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit të vendosura nga Direktiva.

Makinat dhe pajisjet që ju planifikoni të përdorni do të jenë në përputhje me Direktivën 89/392 EEC dhe 91/368 / / EEC, e ndryshuar, pra furnizimet e pajisjeve dhe kërkesat themelore të përcaktuara në dekretit legjislativ nr. 81 / 2008.

Ky dokument permban kërkesat rregullatore "preferenciale" (standartet evropiane) dhe standartet"te aplikueshme" (standartet e kombeve të tjera).

Në rast të mospërputhjes, mospërputhja dhe/ose e kundërta, janë të paraqitura, sipas rendit: standartet kombëtare, standarteve evropiane, standartet e tjera.

Nëse nuk ka pasur standartet kombëtare në lidhje me ndonjë prej impianteve të parashikuara, apo ishin të mangët në lidhje me karakteristikat e performances qe kerkohen do te perdoren tandarteteuropiane ose te vendeve te tjera.

Materialet që janë instaluar në objekt plotësojnë kushtet apo kanë certifikatat e mëposhtme:

UNI-EN-ISO 9000 - "Rregullat referuar kushteve te pergjithshme per kualitetin dhe sigurine ( osegarancine ) e kualitetit. Kriteret e përzgjedhjes apo përdorimit ".

UNI-EN-ISO 9001 - "Sistemet e cilësisë. Kriteret për sigurine ( ose garancine ) e cilësisë nëprojektimin, zhvillimin, prodhimin, instalimin dhe asistencen".

UNI-EN-ISO 9002 - "Sistemet e cilësisë. Kriteret për sigurine ( ose garancine ) e cilësisë nëprodhimin dhe instalimin".

UNI-EN-ISO 9003 - "Sistemet e cilësisë. Kriteret për sigurine ( ose garancine ) e kontrolleve tëcilësisë dhe testeve përfundimtare".

- ***Sigurimi Teknik***

Kontrolli dhe instalimet elektrike duhet te perputhen me kerkesat dhe regullat e IQT dhe SSH ne fuqi.

Bazuar ne Ligjin Nr.8734, datë 1.2.2001 "Per garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike" dhe me VKM vendimin Nr. 245, datë 30.3.2016 ministria e Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave.

- ***Standarte dhe Norma Teknike SSH:***

SSH HD 60364-7-718:2013

- Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 7-718: Kërkesat për instalimet ose vendndodhjet speciale - Mjetet e nevojshme dhe vendet e punës

SSH HD 60364-7-718:2013/A11:2017

- Instalime elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 7-718: Kërkesa për instalimet ose vendndodhjet speciale - Objektet komunale dhe vendet e punës

SSH HD 60364-1:2008

- Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 1: Parimet bazë, vlerësimi i karakteristikave të përgjithshme, përcaktimet

SSH HD 60364-4-41:2007

- Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 4-41: Mbrojtja për garantimin e sigurisë - Mbrojtjakundër goditjeve elektrike

SSH HD 60364-4-42:2011/A1:2015

- Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 4-42: Mbrojtja për garantimin e sigurisë - Mbrojtjakundër efekteve termale

SSH HD 60364-4-43:2010

- Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 4-43: Mbrojtja për sigurinë - Mbrojtja kundër mbirrymave

SSH HD 60364-4-442:2012

- Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 4-442: Mbrojtja për garantimin e sigurisë - Mbrojtjae instalimeve të tensionit të ulët kundër mbitensionit të përkohshëm për shkak të defekteve të tokëzimit në sistemin e tensionit të lartë dhe defekteve në sistemin e tensionit të ulët

SSH HD 60364-4-444:2010/AC:2012

- Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 4-444: Mbrojtja për sigurinë - Mbrojtja kundër çrregullimeve të tensionit dhe çrregullimeve elektromagnetike

SSH HD 60364-5 -51:2009/A11:2013

